



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада / Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of
Communities and Return*

04.05.2026

**THIRRJE PUBLIKE PËR DY ANËTARË (EKSPERTË) TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN
E PROJEKTEVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR FINANCIMIN E
AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT TË SEKTORIT OJQ-ve**

Ministria për Kthim dhe Komunitete ka publikuar thirrje publike për propozime projektsh nga organizatat e shoqërisë civile që synon forcimin e pozicionit socio-ekonomik të anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, përmes mbështetjes së iniciativave që kontribuojnë në integrimin e tyre aktiv në tregun e punës dhe përmirësimin e aftësive dhe punësimit të tyre.

Ministria për Kthim dhe Komunitete fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së MKK-së, do të caktohen në cilësinë e anëtarëve të komisionit vlerësues për projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

- **Thirrje për dy anëtarë**

Si pjesë e thirrjes për projekt propozime, sipas nenit 8 (3.2) të Rregullores së MF-së - nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, MKK-ja hap këtë thirrje publike për përzgjedhjen e dy përfaqësuesve nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri prej të cilëve duhet të jetë përfaqësues i OJQ-së.

- **Detyrat e Komisionit të Vlerësimit**

Detyrat e komisionit vlerësues përcaktohen me rregullore. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Të vlerësojë aplikimet nga aspekti procedural në përputhje me rregulloren;
- Të vendosë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara me rregullore për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;

- Të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikimet/propozimet e aplikuesve të kualifikuar për mbështetje financiare në aspektin e përmbajtjes;
- Të sigurojë që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare ti përmbushin të gjitha kriteret e thirrjes publike dhe të kontribuojnë në arritjen e prioritetëve dhe objektivave të thirrjes;
- Të kërkojë nga aplikuesit dokumentacionin e nevojshëm shtesë pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës;
- Të përzgjedh përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.

• **Kualifikimet**

Për të qenë anëtar i Komisionit të Vlerësimit, kandidatët duhet të kenë këto kualifikime:

- Të kenë kryer me sukses studimet universitare në fushën e shkencave shoqërore, juridike ose ekonomi dhe biznes;
- Të ketë së paku 2 vjet përvojë pune në fushat relevante për thirrjen për propozime;
- Të ketë përvojë në vlerësimin e programeve/projekteve, skemave të granteve ndërkombëtare apo publike;
- Të ketë përvojë ose ekspertizë në një ose më shumë fusha prioritare të mbuluara nga thirrja, duke përfshirë punën me të rinjtë, promovimin e platformave online ose zhvillimin ekonomik ose të biznesit;
- Të jenë fleksibël në kohë për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit Vlerësues me kërkesë të MKK-së.

• **Rregulla të përgjithshme për plotësimin e kërkesave të kualifikimit**

- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit nuk mund të emërohen politikisht;
- Çdo anëtar i Komisionit nënshkruan një deklaratë për paanshmëri dhe konfidencialitet në marrjen e vendimeve;
- Anëtarët e emëruar të Komisionit duhet të sigurojnë paraprakisht që pjesëmarrja e tyre në këtë komision të jetë në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë ku thuhet se nuk ka konflikt interesi. Në rast të një konflikti interesi, anëtarët duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre nga udhëheqësi.

• **Paraqitja e aplikimeve**

Ju lutemi dërgoni CV-në ose rezymet e juaja, dëshmitë e kualifikimeve profesionale dhe referencat për përvojën e punës, jo më vonë se data 18.05.2026, në emailin **request.mkk.mzp.mcr@rks-gov.net**.

MKK mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikuesi nëse të njëjtat nuk janë të kompletuara.